

Sektori për gjykim në afat të arsyeshëm, të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, sipas nenit 68 paragrafi 5 të Rregullores gjyqësore dhe nenit 41 të Rregullores së punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 05.07.2021, nxori këtë:

KONKLUZION

Në procedurën për gjykim në afat të arsyeshëm do të pranohen vetëm shpenzimet, të cilat me të vërtet janë bërë, me domosdoshmëri janë realizuar dhe sipas vëllimit të arsyeshme.

Si shpenzime reale, në procedurën për gjykim në afat të arsyeshëm do të pranohen vetëm prova të dorëzuara në origjinal. Provat e fotokopjuara nuk do të pranohen.

Në procedurën për gjykim në afat të arsyeshëm, kërkesa për përbërjen e autorizimit, nuk do të pranohet si shpenzim real.

Në vendimin e shkallës së parë, në arsyetimin, në fund të vendimit të ketë qëndrim të posaçëm për shpenzimet e procedurës, kurse vendimi i shkallës së dytë të ankesës të qëndrojë si edhe deri tani.

GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË SË VERIUT

SEKTORI PËR GJYKIM NË AFAT TË ARSYESHËM